

Raporti ditor i monitorimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të

Përpara prezantimit të të dhënave faktike mbi procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për pasqyrimin e fushatës zgjedhore 2021, ju bëjmë me dije se:

TV Skampa, TV Rozafa TV RE.AL dhe TV Adria.Net, nuk kanë sjellë më datë 04.04.2021 në AMA regjistrimet e përmbajtjeve audiovizive të datës 03.04.2021.

Nga shkak i një defekti teknik në sistemin e regjistrimit të transmetimeve në AMA, më datë 03.04.2021 (nga ora 13.00 deri më 24.00), si dhe më datë 04.04.2021 (nga ora 08.00 deri më 11.00) nuk është arritur regjistrimi për OSHMA-të: Shijak TV; Ora News; Top News; Report TV, Klan Plus; Kanali 7 dhe TV Adria.Net.

Këto OSHMA janë njoftuar nga Autoriteti që të sjellin përmbajtjet për këto fasha orare deri më datë 05.04.2021, ora 10.00, bazuar në legjislacionin që është në fuqi për regjistrimin dhe depozitim të përmbajtjeve audiovizive të transmetuara.

Megjithë njoftimet e ditëve të mëparshme të AMA-s për TV Bulqiza, ky subjekt edhe më datë 03.04.2021, ora 15.00 ka transmetuar edicionin informativ të një OSHMA-je tjetër.

Janë identifikuar reklama politike të transmetuara jashtë kohës së përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, neni 84, pika 7, OSHMA-të:

TV Shijak	09.29 dhe 12.35
TV Apollon	19.59

Kanë transmetuar reklama politike brenda edicioneve të lajmeve OSHMA-të:

TV Klan News	15.12; 16.29; 16.31; 16.37; 16.40; 17.05; 17.12; 21.03; 21.05; 21.07; 21.16; 21.32; 22.16; 22.18; 22.34 dhe 22.36
TV Alpo	Edicionet e lajmeve 16.00; 18.00; 20.00 dhe 22.00

Bashkëlidhur gjeni kartelat me gjetjet e monitorimit për OSHMA-të e përfshira në monitorim për datën 03.04.2021.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Tiranë, më 04.04.2021